

Nr. 97 Prot.

Tiranë 17/08/2023

**Lënda:** Njoftim për mbledhjen e parë të Komisionit të Pavarur Ad Hoc për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatisë

**Drejtuar:** Z. Ilir DODE  
Avokat

**Dhoma e Avokatisë  
Rruga "Murat Toptani"  
Tiranë**

*I nderuar z. Dode!*

Referuar nenit 26 dhe 124 të nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, pas përfundimit të procedurave për ngritjen e Komisionit të Pavarur Ad Hoc, Avokati i Popullit, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Pavarur Ad Hoc, thërret mbledhjen e parë të tij.

Sa më sipër, në përmbushje të detyrimeve ligjore, dëshirojmë tju bëjmë të ditur se mbledhja e parë e Komisionit të Pavarur Ad Hoc, për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatisë, do të zhvillohet *ditën e enjte, datë 24.08.2023, ora 10.00*, pranë zyrave të Avokatit të Popullit.

Lutemi marrjen e masave të nevojshme për të qene të pranishëm ose në pamundesine tuaj, është e detyrueshme prezenca e anëtarit zëvendësues.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin, mbetemi në pritje të konfirmimit.

*Me respekt,*

AVOKATI I POPULLIT

Erinda BALLANCA

NË MUNGESË DHE ME URDHËR  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Fatbardh Zenelaj

